



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke u mbështetur në nenin 7, paragrafin 1, nënparagrafin 1.31 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 17, paragrafit 1 të Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në takimin e mbajtur me datën 07 qershor 2019, miraton këtë:

RREGULLORE(05/2019)

PËR PROCEDURËN DISIPLINORE TË PROKURORËVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi dhe definimi i procedurave për pranimin, shqyrtimin, hetimin dhe vendosjen e ankesave për shkelje disiplinore ndaj prokurorëve, si dhe organizimin e punës së autoriteteve kompetente dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tutje Këshilli).
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha autoritetet kompetente, Këshillin dhe prokurorët, përfshirë prokurorët që gjatë procedurës disiplinore kanë lënë detyrën ose kur funksioni i të cilëve është ndërprerë në ndonjë mënyrë tjetër siç parashihet me Ligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve (më tutje Ligji).

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1 Autoritet kompetent** - nënkupton kryeprokurorët e prokurorive, Kryeprokurorin e Shtetit dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, si autoritete kompetente për pranimin e ankesave ndaj prokurorëve për shkeljet e supozuara disiplinore sipas nenit 9, paragrafi 1 të Ligjit;
 - 1.2 Këshilli** - nënkupton Këshillin Prokurorial të Kosovës;
 - 1.3 Kryeprokuror** - nënkupton Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore, Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Kryeprokurorin e Prokurorisë së Apelit, dhe Kryeprokurorin e Shtetit;

- 1.4 **Vepër e rëndë penale** - nënkupton veprat penale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- 1.5 **Palë në procedurën disiplinore** – nënkupton subjektin e hetimit disiplinor. Në varësi të rrjedhës së procedurës disiplinore palë janë: parashtruesi i ankesës, Kryeprokurori, Këshilli dhe Avokati i Popullit;
- 1.6 **Paneli hetimor**- tre (3) prokurorë të caktuar nga Këshilli për të qenë anëtarë të panelit hetimor;
- 1.7 **Konflikt interesi** – lind nga një rrethanë, në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare;
- 1.8 **Zyrtar** – Zyrtar për mbështetje profesionale dhe administrative;
- 1.9 **Ligji** – Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- 1.10 Fjalët e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 3

Parimet e procedurës disiplinore ndaj prokurorëve

1. Procedura disiplinore ndaj prokurorëve zbatohet duke u bazuar në parimet si në vijim:
 - 1.1 **Parim i ligjshmërisë** - Në procedurën disiplinore, autoriteti kompetent zhvillon procedurat dhe vendosë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve.
 - 1.2 **Parimi i ruajtjes së fshehtësisë zyrtare** – Kryeprokurori, zyrtari kompetent dhe prokurorët anëtarë të panelit hetimor kanë për obligim të ruajnë fshehtësinë dhe të mos ndajnë informata privatisht apo publikisht (konfidencialitetin) lidhur me procedurën disiplinore deri në momentin kur vendimi për shqiptimin e masës disiplinore ndaj prokurorit bëhet i formës së prerë. Shkelja e këtij parimi shërben si bazë për procedurën disiplinore ndaj prokurorit apo zyrtarit kompetent.
 - 1.3 **Parimi i mosdiskriminimit të palëve** - Parimi i mosdiskriminimit të palëve nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të mosdiskriminimit të palëve.
 - 1.4 **Parimi i prezumimit të pafajësisë** - Çdo prokuror, ndaj të cilit inicohet procedura për sjellje disiplinore, konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet shkelja e tij me vendim të formës së prerë.
 - 1.5 **Parimi i qasjes së barabartë** - Autoriteti kompetent duhet të veprojnë me transparencë, të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar për ecurinë e procedurës disiplinore, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë rregullore. Të drejtat e parashikuara nga ky nen kufizohen me ligj kur është e

domosdoshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, mbrojtjen e të dhënave personale apo të dhënave afariste dhe profesionale, të cilat janë mbrojtura sipas Ligjit.

1.6 Parimi i proporcionalitetit – Një veprim i autoriteteve kompetente në procedurë disiplinore, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, nëse është i domosdoshëm dhe i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj.

Neni 4

Pranimi dhe regjistrimi i ankesës

1. Ankesa për shkelje të supozuar disiplinore ndaj prokurorit apo kryeprokurorit dorëzohet në prokurorinë përkatëse, në të cilën shërben prokurori apo në Këshill, siç është paraparë në nenin 9, paragrafët 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit.
2. Ankesa pranohet nga autoriteti kompetent apo nga zyrtari i autorizuar nga ky autoritet. Autoriteti kompetent e njofton menjëherë Këshillin me shkrim lidhur me pranimin e ankesës.
3. Autoriteti kompetent mban regjistrin fizik dhe elektronik për regjistrimin e të gjitha ankesave të parashtruara nga personat fizikë dhe juridikë. Regjistri është unik për të gjitha prokuroritë dhe përpilohet nga Këshilli (Shtojca nr.1 e kësaj rregulloreje).
4. Ankesa e paraqitur merr numrin unik si në vijim:
 - 4.1 AD (Ankesa disiplinore);
 - 4.2 PTH (Prokuroria Themelore);
 - 4.3 Numri rendor, sipas radhës: 01,02, 03;
 - 4.4 Data e pranimin të ankesës (p.sh.1/2019).
5. Regjistri duhet t'i përmbajë edhe informatat në vijim:
 - 5.1 Nr. rendor;
 - 5.2 Numri i lëndës dhe data e pranimin;
 - 5.3 Ushtruesi i ankesës (emri dhe mbiemri);
 - 5.4 Emrin dhe mbiemrin e prokurorit, ndaj të cilit paraqitet ankesa;
 - 5.5 Shkeljen e supozuar disiplinore, të cilën pretendohet se prokurori e ka kryer;
 - 5.6 Provat e paraqitura apo dëshmitarët e propozuar;
 - 5.7 Njoftimi për KPK-në për pranimin e ankesës (data e njoftimit);
 - 5.8 Njoftimi në Institucionin e Avokatit të Popullit (data e njoftimit);
 - 5.9 Vendimi i autoritetit kompetent (data e vendimit);
 - 5.10 Njoftimi i palës ankuese për vendimin e autoritetit kompetent (data e njoftimit);
 - 5.11 Njoftimi lidhur me vendimin e autoritetit kompetent për KPK-në dhe IAP-in (data e njoftimit);
 - 5.12 Referimi i çështjes te Prokurori i Shtetit dhe njoftimi i KPK-së dhe IAP-it (data e njoftimit);

- 5.13 Kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore (data e kërkesës);
 - 5.14 Raporti i Panelit hetimor (data e pranimit);
 - 5.15 Kërkesa për pezullim/suspendim (data e kërkesës);
 - 5.16 Vendimi i KPK-së (data e pranimit);
 - 5.17 Përgjigjja në ankesë dhe
 - 5.18 Vendimi i Gjykatës Supreme (data e pranimit).
6. Të drejtë qasjeje në këtë regjistër ka vetëm autoriteti kompetent, personi i autorizuar nga autoriteti kompetent, Këshilli dhe personat e autorizuar nga Këshilli.

Neni 5

Forma e ankesës

1. Ankesat pranohen me shkrim, në kopje fizike apo elektronike, si dhe duhet të përmbajnë të dhënat si në vijim:
 - 1.1 Identitetin e personit fizik ose juridik, i cili e paraqet ankesën;
 - 1.2 Identitetin e prokurorit, i cili pretendohet se ka kryer shkelje disiplinore;
 - 1.3 Një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike, mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore;
 - 1.4 Kohën e kryerjes së shkeljes së supozuar disiplinore, nëse nuk dihet periudha e saktë apo vepra është kryer në vazhdimësi, periudha kohore brenda së cilës pretendohet se prokurori e ka kryer shkeljen disiplinore.
2. Këshilli harton një mostër për hartimin e ankesave, e cila do të publikohet në uebfaqen e Këshillit. Kjo mostër do të jetë në dispozicion edhe në kopje fizike në Gjykatë dhe në Këshill. Mostra nuk është obliguese për palët.
3. Çdo ankesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë, kur nga përmbajtja del se qëllimi i palës është të paraqesë një pretendim për shkelje disiplinore nga ana e prokurorit.
4. Personat që nuk dinë shkrim dhe lexim mund të paraqesin gojarisht pretendimet e tyre për shkeljet disiplinore të prokurorit të autoriteti kompetent ose zyrtari i autorizuar nga ky autoritet dhe pretendimet e tilla shënohen në formë të procesverbalit, i cili e ka peshën e ankesës me shkrim.

Neni 6

Shqyrtimi fillestar nga autoriteti kompetent

1. Pas pranimit të ankesës, autoriteti kompetent shqyrton ankesën brenda 30 ditëve, duke u siguruar se ankesa përmban elementet e parapara me nenin 5 të kësaj rregulloreje. Në çdo rast kur ekziston konflikti i interesit, autoriteti kompetent njofton autoritetin kompetent të instancës më të lartë prokuroriale. Kjo instancë konstaton nëse ekziston konflikti i interesit dhe nëse konstaton se konflikti i interesit ekziston vendosë vetë lidhur me çështjen.

2. Nëse autoriteti kompetent konsideron se ankesa nuk është e qartë, është e mangët dhe përmban informata të papërcaktuara, autoriteti mund të kërkojë informata plotësuese nga ankuesi. Ankuesi duhet t'i përgjigjet autoritetit kompetent brenda 8 ditëve nga dita e pranimin të kërkesës.
3. Nëse ankesa nuk i përmban elementet e përcaktuara sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje mund të trajtohet nga autoriteti kompetent sipas detyrës zyrtare, nëse përmbajnë informata bindëse se prokurori ka kryer shkelje disiplinore.
4. Autoriteti kompetent mund të kërkojë deklaratë nga prokurori, pasi që t'i shqyrtojë të gjitha provat, deklaratën e prokurorit dhe shkresat e tjera që ka në dispozicion, pastaj vendos për veprimin e mëtejshëm.
5. Rastet kur shkelja e supozuar disiplinore përmban elemente të veprës penale, autoriteti kompetent sipas detyrës zyrtare ia referon çështjen prokurorit të shtetit, si dhe njofton Këshillin dhe Avokatin e Popullit në rastet kur procedura është iniciuar nga Avokati i Popullit.
6. Referimi i çështjes te prokurori e ndërpret parashkrimin dhe suspendon procedurën disiplinore.
7. Në rastet kur prokurori i shtetit vendos të mos e ndjekë prokurorin penalisht për shkeljen dhe lidhur me këtë e njofton autoritetin kompetent, ai e shqyrton ankesën siç është e paraparë me këtë rregullore.
8. Nëse procedura penale rezulton me dënim penal apo lirim nga akuza, autoriteti kompetent ka për obligim të procedojë më tej ankesën për shkelje disiplinore.
9. Procedura disiplinore rifillon në momentin e marrjes së vendimit të formës së prerë nga ana e prokurorit apo gjykatës lidhur me çështjen në fjalë.
10. Nëse kryeprokurori nuk shqyrton dhe nuk vendos lidhur me ankesën ose nuk e njofton personin që ka paraqitur ankesë për arsyet e hedhjes poshtë të saj, siç kërkohet në paragrafin 6, konsiderohet se ka kryer shkelje disiplinore.

Neni 7

Veprimet e kryeprokurorit pas shqyrtimit fillestar

1. Pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare, autoriteti kompetent mundet ta hedhë ankesën, ta refuzojë dhe të kërkojë fillimin e hetimeve nga Këshilli.
2. Ankesa hidhet siç është paraparë me nenin 9, paragrafin 6 të Ligjit dhe kur autoriteti kompetent konstaton se ankesa është:
 - 1.1. Anonime dhe
 - 1.2. Shkelja e supozuar është parashkruar.

3. Autoriteti kompetent e refuzon ankesën nëse konstaton se ankesa është:

3.1. Dukshëm joserioze dhe

3.2. E pabazuar, sepse nuk ka të bëjë me shkelje disiplinore.

4. Lidhur me vendimin e marrë, autoriteti kompetent e njofton menjëherë me shkrim palën, e cila e ka paraqitur ankesën, prokurorin ndaj të cilit është paraqitur ankesa, Këshillin dhe Avokatin e Popullit, në rastet e parapara me ligj.

Neni 8

Kërkesa për fillimin e hetimit

1. Autoriteti kompetent ia paraqet Këshillit kërkesën për fillimin e hetimeve në rastet kur ankesa nuk është hedhur apo refuzuar sipas këtij neni.
2. Autoriteti kompetent mund të kërkojë nga Këshilli fillimin e hetimeve ndaj një prokurori sipas detyrës zyrtare nëse konsideron se ka bazë të arsyeshme të besojë se një prokuror ka kryer shkelje disiplinore.
3. Kërkesa për fillimin e hetimeve duhet t'i përmbajë këto elemente:
 - a. Identitetin e prokurorit që do të hetohet;
 - b. Përshkrim sa më të saktë të aspekteve faktike dhe juridike, mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore;
 - c. Propozimin për shqiptimin e masës disiplinore në përputhje me ligjin;
 - d. Përshkrimin e saktë të veprimeve të ndërmarra nga kryeprokurori dhe të gjitha shkresat, deklaratat e palëve ose provat eventuale të mbledhura gjatë fazës së shqyrtimit fillestar dhe
 - e. Datën e kërkesës.
4. Autoriteti kompetent, në momentin kur ia dorëzon Këshillit kërkesën për hetim, njëkohësisht, informon edhe prokurorin që është subjekt i hetimit.

Neni 9

Pranimi dhe regjistrimi i kërkesës për fillimin e hetimeve në Këshill dhe ankesa

1. Këshilli e pranon dhe regjistron kërkesën e kryeprokurorit apo autoritetit tjetër kompetent në regjistrin përkatës fizik dhe elektronik.
2. Ankesën e dërguar në Këshill nga palët ankuese ndaj një prokurori që pretendohet se ka kryer shkelje disiplinore, Këshilli e dërgon te autoriteti kompetent për shqyrtim fillestar në pajtim me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

3. Regjistri përmban të gjitha të dhënat lidhur me ankesën sikurse edhe regjistri i autoritetit kompetent siç është paraparë me nenin 4, paragrafin 5 të kësaj rregulloreje, përfshirë të dhënat e hetimit disiplinor, shkresat, dëshmitë dhe sanksionin e shqiptuar nga Këshilli.
4. Shënimet sa i përket shqiptimit të masës disiplinore fshihen pas pesë (5) vjetëve nga data e plotfuqishmërisë së vendimit me përjashtim të sanksioneve disiplinore të shqiptuara për shkelje të qëllimshme të Ligjit ose për shkelje që kanë rezultuar me shqiptim dënimi për vepër të rëndë penale.
5. Çdo ankesë e pranuar në Këshill merr numrin unik, si në vijim: AD/KPK/01/2019/PTHPR_NR (i Ankesës).

Neni 10 **Shqyrtimi i kërkesës për fillimin e hetimeve**

1. Zyrtari i autorizuar nga Këshilli është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së ankesës për shqyrtim nga Këshilli. Dosja duhet të përmbajë të gjitha shkresat, provat dhe deklaratat eventuale lidhur me ankesën dhe kërkesën e autoritetit kompetent për fillimin e hetimeve.
2. Seancat e Këshillit për shqyrtimin e kërkesave për fillim të hetimeve nga autoriteti kompetent janë të mbyllura.
3. Këshilli duhet të mbajë seancë për shqyrtimin e kërkesës për fillimin e hetimeve dhe themelojë panelin hetues brenda 15 ditëve, nga dita e marrjes së kërkesës.
4. Këshilli pas shqyrtimit të kërkesës së pranuar nga Avokati i Popullit për fillimin e hetimeve ndaj kryeprokurorit ose prokurorit të prokurorisë përkatëse, vendosë lidhur me kërkesën dhe ka të drejtë ta hedhë, refuzojë ose t'i fillojë hetimet në pajtim me nenin 12, paragrafin 3 të Ligjit.
5. Këshilli mund të bëjë bashkimin e procedurës.

Neni 11 **Përzgjedhja e prokurorëve për të qenë pjesë e listës së panelit hetimor**

1. Këshilli përpilon dhe përditëson listën e prokurorëve që mund të jenë pjesë e paneleve hetimore nga lista e përgjithshme e prokurorëve. Lista mund të përfshijë deri në 40, por jo më pak sesa 15 prokurorë.
2. Prokurorët e përzgjedhur nga Këshilli nuk mund të refuzojnë detyrën për të qenë anëtarë të panelit.
3. Prokurorët që do të përfshihen në këtë listë duhet të jenë nga të gjitha nivelet e prokurorëve të Republikës së Kosovës dhe duhet t'i plotësojnë këto kritere:
 - 3.1. Të kenë reputacion të lartë profesional;

- 3.2. Të kenë integritet të lartë moral dhe etikë profesionale;
 - 3.3 Të mos jenë të dënuar për veprë penale me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 3.4 Të jenë prokurorë me mandat të përhershëm dhe
 - 3.5 Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore.
4. Këshilli bën verifikimin e prokurorëve të përfshirë në këtë listë.
 5. Këshilli miraton listën e prokurorëve për të qenë në listë të paneleve hetimore dhe njofton kryeprokurorët dhe prokurorët përkatës për përfshirjen e prokurorëve të tyre në këtë listë.
 6. Prokurori është pjesë e listës së panelit hetimor për tre (3) vjet, përjashtimisht deri në përfundim të procedurës disiplinore të iniciuar.
 - 5 Nëse gjatë periudhës sa prokurori është pjesë e listës së panelit hetimor, ndodhë njëra nga situatat e parapara nën paragrafin 2 të këtij neni, prokurori automatikisht largohet nga lista dhe zëvendësohet sipas procedurave të rregullta për zgjedhjen e prokurorit për panele hetimore.
 - 6 Prokurorët që caktohen të jenë pjesë e kësaj liste, sipas këtij neni, kanë për obligim të jenë në dispozicion për të shërbyer në panele dhe koordinojnë punën e tyre në prokurori në bashkëpunim me kryeprokurorin.
 - 7 Prokurorët e përfshirë në listën përfundimtare, pas miratimit në Këshill, duhet të ndjekin trajnimet adekuate.

Neni 12

Themelimi i panelit hetimor

1. Këshilli themelon panel hetimor për të hetuar shkeljet e supozuara disiplinore nga lista e përpiluar sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje. Paneli përbëhet prej tre (3) prokurorësh, të zgjedhur me short, të cilët vijnë nga prokuroritë e tjera dhe jo nga prokuroria ku shërben prokurori që hetohet.
2. Këshilli e përcakton kryesuesin e panelit hetimor nga radhët e anëtarëve të panelit.
3. Këshilli cakton edhe dy anëtare rezervë për çdo panel hetues.
4. Së paku njëri nga anëtarët e panelit mund të jetë prokurorë nga lëmia përkatëse, ashtu sikurse edhe prokurori, ndaj të cilit fillon hetimi.

5. Paneli hetimor mbështetet nga zyrtarët e Këshillit, të cilët ofrojnë ndihmë profesionale dhe administrative. Zyrtarët mbështetës duhet të kenë integritet të lartë profesional dhe moral, të ruajnë fshehtësinë zyrtare dhe të veprojnë në pajtim me dispozitat e Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Zyrtari ka për obligim në çfarëdo kohe kur beson se mund të ekzistojë konflikti i interesit ta njoftojë eprorin e tij si dhe kryesuesin e panelit hetimor.

Neni 13

Konflikti i interesit dhe përjashtimi

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit dhe të panelit hetimor para dhe gjatë gjithë zhvillimit të procedurës hetimore dhe disiplinore, apo në momentin kur paraqiten rrethanat, të cilat mund të rezultojnë më konflikt të interesit, janë të obliguar të njoftojnë me shkrim Këshillin, respektivisht, kryesuesin e panelit hetimor.
2. Në çdo kohë palët mund t'i drejtohen Këshillit, respektivisht, kryesuesit të panelit dhe të kërkojnë përjashtimin e anëtarit ose Këshillit ose të panelit hetimor kur paraqiten rrethanat, të cilat mund të rezultojnë me konflikt të interesit. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar mirë dhe të shpjegojë bazën mbi të cilin ngritët dyshimi.
3. Në të gjitha rastet kur paraqitet konflikti i interesit ndërpritet procedura derisa të vendoset për pretendimet e palëve.
4. Kryesuesi i Këshillit, Këshilli apo kryesuesi i panelit vendos lidhur me kërkesat rreth konfliktit të interesit. Nëse kërkesa rezulton me përjashtim të anëtarit të Këshillit, Kryesuesit të Këshillit, kryesuesit apo anëtarit të panelit, ai/ajo zëvendësohet respektivisht në rastet e anëtarëve të Këshillit dhe përjashtohet nga procedura.
5. Kryesuesi i Këshillit, Këshilli, respektivisht, kryesuesi i panelit vendos për çështjen jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e pranimit të kërkesës

Neni 14

Veprimet procedurale të panelit hetimor

1. Paneli njofton me shkrim prokurorin, i cili është subjekt i hetimit për fillimin e procedurës hetimore. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë:
 - 1.1 Shkeljen e supozuar për të cilën prokurori hetohet;
 - 1.2 Përbërjen e panelit hetues;
 - 1.3 Të drejtën për t'u dëgjuar në lidhje me ankesën;
 - 1.4 Të drejtën e qasjes së plotë në dosjen disiplinore;
 - 1.5 Të drejtën për t'u informuar rreth zgjerimit të hetimeve;

1.6 Të drejtën për të paraqitur prova, dokumente apo dëshmitarë dhe

1.7 Të drejtën për t'u përfaqësuar nga avokati mbrojtës gjatë procedurës disiplinore.

2. Në rast se prokurori, i cili është subjekt i hetimit autorizon avokatin mbrojtës për ta përfaqësuar, prokurori duhet ta informojë panelin hetimor.
3. Paneli hetimor zhvillon hetimet bazuar në ligj brenda tre (3) muajve nga dita e themelimit. Në qoftë se paraqiten rrethana të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës së panelit hetimor, Këshilli mund ta zgjasë mandatin e panelit edhe për dy (2) muaj shtesë.
4. Në rast se gjatë hetimit, paneli hetimor ka gjetur se prokurori ka kryer edhe shkelje të tjera që nuk ndërlidhen me shkeljen për të cilën ka filluar hetimi, ai njofton Këshillin dhe autoritetin kompetent, i cili do të veprojë në përputhje me nenin 12 dhe paragrafin 2 të Ligjit.
5. Brenda 15 ditëve, pas përfundimit të hetimit, paneli dorëzon raport me shkrim Këshillit, prokurorit që është subjekt i hetimit dhe autoritetit kompetent, i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve. Në raport saktësohen të gjeturat mbi të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore. Palët informohen se kanë qasje të plotë në të gjitha provat e mbledhura dhe dosjet e lëndës.
6. Gjatë procedurës hetimore, Këshilli ex officio ose me kërkesë të autoritetit kompetent, i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve, mund të pezullojë prokurorin që është nën hetime nëse një gjë e tillë është e nevojshme, duke marrë parasysh seriozitetin e veprës së pretenduar penale dhe të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve. Pezullimi rezulton me zvogëlimin e pagës mujore siç është paraparë me nenin 12 dhe paragrafin 10 të Ligjit.
7. Paneli hetimor ka të drejtë që gjatë procedurës hetimore të lidhë marrëveshje vullnetare me prokurorin që është subjekt i procedurës hetimore. Marrëveshja duhet të jetë në pajtim me nenin 13 dhe paragrafin 2 të Ligjit.
8. Marrëveshja vullnetare dorëzohet për shqyrtim dhe aprovim në Këshill.

Neni 15

Procedura disiplinore

1. Këshilli cakton seancë dëgjimore në periudhën kohore prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të raportit me shkrim mbi hetimin e prokurorit apo të pranimit të marrëveshjes, bazuar në nenin 13 të Ligjit. Këshilli mund të mbajë më tepër seanca dëgjimore në qoftë se një gjë e tillë kërkohet për shkak të kompleksitetit të rastit.
2. Palët njoftohen me shkrim nga Këshilli lidhur me datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës dëgjimore. Njoftimet lëshohen me autorizim të Kryesuesit të Këshillit.

3. Këshilli mund të ftojë për seancë dëgjimore dëshmitarët dhe ekspertët e propozuar nga palët në procedurë.
4. Këshilli merr vendim brenda afatit të paraparë me nenin 14 dhe paragrafin 6 të Ligjit.
5. Seancat e Këshillit janë të mbyllura.

Neni 16 **Korrespondenca me palë**

1. Ftesat dhe shkresat e tjera u dorëzohen personalisht palëve ose përmes postës elektronike.
2. Pranimi i shkresave konfirmohet përmes fletëkthesës së nënshkruar nga pala ose përmes pranimit të konfirmimit elektronik se pala e ka lexuar shkresën.

Neni 17 **Incizimi i seancës dëgjimore**

1. Seanca dëgjimore incizohet me audioincizim, në të njëjtën mënyrë siç bëhet incizimi i mbledhjeve të Këshillit.
2. Transkriptimi nga audioincizimi shërben si procesverbal në procedurën dëgjimore.

Neni 18 **Zhvillimi i seancës**

1. Kuorumi për mbajtjen e procedurës disiplinore përbëhet nga nëntë (9) anëtarë të Këshillit.
2. Kryesuesi i Këshillit e hap seancën dhe konstaton:
 - 2.1 Numrin e lëndës;
 - 2.2 Datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës;
 - 2.3 Numrin e anëtarëve (kuorumin) të pranishëm të Këshillit;
 - 2.4 Numrin e palëve në procedurë dhe përfaqësuesit e pranishëm;
 - 2.5 Pjesëmarrësit e tjerë të pranishëm me leje të Këshillit.
3. Kryesuesi konstaton nëse palët kanë vërejtje rreth përbërjes së Këshillit. Nëse palët kanë vërejtje veçohet sipas dispozitave të nenit 13 të kësaj rregulloreje. Seanca shtyhet nëse përjashtimi i anëtarit rezulton me humbjen e kuoromit të Këshillit.

4. Seanca shtyhet nëse prokurori apo ndonjëra nga palët në procedurë paraprakisht informon Këshillin për pamundësinë që të marrë pjesë në seancë dhe Këshilli konsideron arsyen si objektive.
5. Kryesuesi i Këshillit në fillim ia jep fjalën kryesuesit të panelit, i cili prezanton një përmbledhje të shkurtër të raportit me shkrim dhe paraqet të gjitha provat që mbështesin të gjeturat e parashtruara në raportin me shkrim.
6. Më pas, Kryesuesi ia jep fjalën prokurorit, i cili deklarohej shkurtimisht përkitazi me raportin me shkrim. Këshilli mund t'i dëgjojë palët apo dëshmitarët nëse e sheh të arsyeshme lidhur me shkeljen e pretenduar disiplinore për të kundërshtuar apo pranuar pohimet e parashtruara në raportin me shkrim.
7. Nëse palët propozojnë dëshmitarë apo prova shtesë, atëherë, Kryesuesi mund ta shtyjë seancën për t'i thirrur dëshmitarët shtesë apo për të shqyrtuar provat e reja. Shtyrja duhet të jetë në kohë të arsyeshme.
8. Anëtarët e Këshillit mund t'i shtrojnë pyetje palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve. Palët mund t'i parashtrorjnë pyetje dëshmitarëve dhe ekspertëve.
9. Palët paraqesin fjalën përfundimtare pas përmbylljes së administrimit të provave. Fjala përfundimtare mund t'i referohet dëshmiave, provave të tjera të pranuar dhe dispozitave të Ligjit. Fjalën përfundimtare, së pari, e paraqet kryesuesi i panelit, pastaj prokurori apo avokati mbrojtës, e cila mund të paraqitet edhe në formë të shkruar.
10. Pas fjalës përfundimtare, palët njoftohen se seanca dëgjimore ka përfunduar dhe vendimet me shkrim do t'i marrin brenda afatit të paraparë ligjor.
11. Prokurori mund të pranojë në çdo kohë gjatë procedurës disiplinore se ka bërë shkeljen disiplinore të paraqitur në raportin me shkrim.

Neni 19 Këshillimi dhe votimi

1. Pas përfundimit të seancës disiplinore, Këshilli mban seancë të mbyllur dhe vendos lidhur me çështjen.
2. Në seancën për këshillim dhe votim, përveç anëtarëve të Këshillit, merr pjesë edhe zyrtari që ofron mbështetje profesionale dhe administrative, si dhe kur është e nevojshme edhe përkthyesi.

3. Këshilli vendosë me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm për secilën shkelje të paraqitur në raportin me shkrim. Mendimi mospajtues i ndonjërit anëtar të Këshillit shënohet në procesverbal.
4. Kur konstatohet shkelja disiplinore, Këshilli shqipton njërin nga sanksionet e parapara në nenin 7 të Ligjit.
5. Procesverbali për këshillimin dhe votimin përpilohet nga zyrtari, kurse nënshkruhet nga anëtarët dhe mbyllet në zarf të vulosur. Ky dokument është konfidencial dhe i bashkëngjitet lëndës.

Neni 20 Hartimi i vendimit

1. Vendimi i Këshillit hartohet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim.
2. Vendimi përmban hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe këshillën juridike.
3. Vendimin e nënshkruan Kryesuesi i Këshillit.
4. Kopja e vendimit i dërgohet autoritetit kompetent, prokurorit, kurse dhe në raste të parapara me ligj edhe Avokatit të Popullit, brenda afatit prej pesë (5) ditësh pas nënshkrimit të vendimit. Konfirmimin për pranimin e vendimit e siguron zyrtari për mbështetje profesionale dhe administrative, me të cilin dëshmohet se palët kanë pranuar vendimin e Këshillit dhe i bashkëngjitet lëndës.

Neni 21 Korrigjimet teknike

Sipas detyrës zyrtare, apo me kërkesë të ndonjëres palë, Kryesuesi i Këshillit mund t'i korrigjojë gabimet eventuale teknike në vendimin e Këshillit.

Neni 22 Ankesa ndaj vendimeve disiplinore

1. Palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ankesa duhet të parashtrohet brenda 15 ditëve nga dita e pranimin të vendimit të Këshillit.
2. Afati nga paragrafi 1 i këtij neni vlen edhe për rastet e paraqitjes së ankesës sipas nenit 14, paragrafi 6 dhe nenit 12, paragrafit 3 të Ligjit.

3. Ankesa ndaj vendimit të Këshillit suspendon dhe shtyn zbatimin e tij deri në nxjerrjen e vendimit nga Gjykata Supreme.

Neni 23

Veprimet e Këshillit pas vendimit të Gjykatës Supreme lidhur me ankesën

1. Në rastet kur Gjykata Supreme vendos ta kthejë çështjen në rishqyrtim, atëherë Këshilli vendos brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e marrjes së vendimit.
2. Këshilli vepron në bazë të udhëzimeve të Gjykatës Supreme. Pas marrjes së vendimit, Këshilli e njofton Gjykatën Supreme, autoritetin kompetent dhe palën.

Neni 24

Regjistrimi dhe publikimi i vendimeve përfundimtare

1. Vendimi përfundimtar bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e marrjes së vendimit përfundimtar.
2. Vendimi publikohet në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Sekretariati i Këshillit mban regjistër për vendimet përfundimtare.

Neni 25

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja e Këshillit nr.05.2015 për punën e komisionit disiplinor dhe procedurën disiplinore ndaj prokurorëve.
2. Mandati i anëtarëve të panelit gjatë tri vjetëve të para do të përcaktohet në këtë mënyrë: Një e treta (1/3) e prokurorëve të përzgjedhur për të shërbyer në panel hetimor do të kenë mandat prej 1 (një) viti, një e treta do të kenë mandat prej dy (2) vjetësh dhe një e treta do të ketë mandat prej 3 (tre) vjetësh. Përzgjedhja e prokurorëve me mandate të ndryshme do të bëhet me short. Pas rundit të parë të zgjedhjes së anëtarëve për të shërbyer në panele hetimore, të gjithë anëtarët e tjerë do të kenë mandat të rregullt trevjeçar.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Bahri Hyseni
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

